



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**AC-I-24-0231**

***Në ankesën e***

***Paditësi***

**I L** nga Gjilani.

***Kundër***

***E paditura/Ankuesja***

**N.SH "Industria e Baterive-IBG" (në likuidim),** të cilin e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit,** rruga "Dritan Hoxha" nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Hasim Sogojeva dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2989 të datës 29 shkurt 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 gusht 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-2989 i datës 29 shkurt 2024**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 14 nëntor 2013, përmes postës paditësi, ish punëtorë i NSH-së "Industria e Baterive-IBG" në Gjiilan e ka dorëzuar një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të NSH Industria e Baterive "IBG" në Gjiilan GJI058-0562 të datës 04 tetor 2013 me të cilin ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës, në shumën totale prej 1,050.00 euro nga NSH- Industria e Baterive "IBG" në Gjiilan. Paditësi në ankesë ka pohuar se ai ishte punëtor i NSH-së deri në ditën e privatizimit të saj me 20 maj 2012, me ç'rast atij i është dorëzuar njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Tutje ai pohon se duke u bazuar në këtë njoftim pasi ka filluar procedura e likuidimit ndaj NSH-së ka paraqitur kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit. Në ankesë ai pohon se nuk është i saktë konstatimi i Autoritetit të Likuidimit se ai nuk ishte punëtor aktiv i NSH-së dhe se gjoja se nuk ka ofruar shërbime punë në NSH. Bashkë me ankesë ai ka dorëzuar vendimin e ankimuar të Autoriteti i Likuidimit, kopjen e Librezës së punës e mbyllur me 22 maj 2012, një vërtetim për marrëdhënie pune.

Me datë 25 korrik 2014, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se në bazë të arkivës së NSH –së privatizimi ishte përfunduar me datë 18 maj 2012, ndërsa paditësi nuk ishte pjesë e listës së pagave për muajt e fundit para privatizimit të ndërmarrjes, andaj ai nuk ishte punëtor aktiv dhe nuk kishte të drejtë të kërkojë kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, duke u bazuar në nenin 40.1.6.2 të Shtojcës të Ligjit të AKP-së. AKP-ja pohon se kërkesa e paditësit është parashkruar pasi që ai nuk ishte në listën e pagave para privatizimit të NSH-së. AKP-ja po ashtu pohoi se ishte obligim i paditësit të paraqesë prova për të mbështetur pretendimin e tij se ishte në marrëdhënie pune në NSH, apo se ka punuar ndonjë punë në NSH. Bashkë me këtë parashtresë AKP-ja ka sjellë një listë të pagave të punëtorëve.

Me datë 10 shtator 2014, paditësi e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në mbrojtjen në padi. Në këtë parashtresë paditësi pohon se kërkesa e tij nuk është parashkuar siç pretendon pa bazë AKP-ja, ndërsa ndarja e punëtorëve në aktiv dhe pasiv nuk ka mbështetje në asnjë dispozitë të zbatueshme ligjore. Në këtë parashtresë prap ka kërkuar ë të njihet e drejta për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Me datë 31 tetor 2014, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundërpërgjigjen, në të cilën ajo i përsërit pretendimet dhe argumentet e saj të paraqitura në mbrojtjen në padi, dhe kërkon që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 29 shkurt 2024, shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-2989, e aprovoi ankesën e paditësit si të bazuar, e ndryshoi vendimin e Autoritetit të Likuidimit dhe obligoi të paditurën që në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës ti paguaj paditësit shumën prej 1,050.00 euro, e cila shumë do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurë të likuidimit. Shkalla e I-rë konstaton se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH "Industria e Baterive". Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se a ka qenë ankuesi punëtor i NSH në momentin e privatizimit të saj. Paditësi pretendon se ka qenë punëtor i NSH-së, deri sa ndërmarrja ka shkuar në privatizim me datë 06 gusht 2012. Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në Njoftimin e datë 06 gusht 2012 për hyrjen e NSH-së në likuidim, librezën e punës, listën përfundimtare të punëtorëve, si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga librezja e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte krijuar marrëdhënie pune me në vitin 1981 deri në vitin 2012 (më privatizimin e ndërmarrjes në fjalë). Andaj, gjykata i pranon si prova relevante librezën e punës, njoftimin e datës 06 gusht 2012, si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se paditësi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se paditësit ia kishte

ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së. Me rastin e aprovimit të shtatë pagave mujore në lartësi prej 150.00 € apo shumës totale prej 1,050.00 €, në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 76.7.7.4 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe pagën të cilën e ka llogaritur vetë ankuesi në kërkesën e tij në procedurë të likuidimit tek AL si dhe me rastin e parashtrimit të ankesës së tij në gjykatë. Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Gjykata vlerëson se e paditura nuk ka mundur të dëshmojë faktin se ankuesi nuk e ka pasur statusin e punëtorit të NSH dhe faktin se me cilën bazë ligjore e ka bërë ndarjen e punëtorëve aktiv dhe pasiv, pasi që asnjë dispozitë ligjore e zbatueshme në Republikën e Kosovës nuk e parasheh këtë ndarje. Ligji i Punës i cili është në fuqi nga viti 2010, parasheh, mënyrën e themelimit të marrëdhënies së punës, përfundimin e një marrëdhënie të punës dhe të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve që janë në marrëdhënie pune te një punëdhënës i caktuar. Nga provat e lartcekura, përkatësisht nga librezat e punës shihet që ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune me NSH deri në kohën e privatizimit të saj, ndërsa e paditura nuk ka dëshmuar se me ndonjë akt të ligjshëm ia kishte ndërprerë ankuesit marrëdhënien e punës para kohës së privatizimit. Po ashtu gjykata vlerëson se ankuesi ka mundur që mos të pranojë pagë dhe të mos jetë në listën e pagave në muajt e fundit para privatizimit, por kjo nuk do të thotë se ai e ka humbur statusin e të punësuarit në NSH. Nisur nga kjo gjendje, gjykata nxjerr përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar. Një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit (AC-I-21-0041, AC-I-21-0039, etj.).

Me datë 22 mars 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS, një ankesë kundër aktgjyqimit të shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-13-2989, të datës 29 shkurt 2024, për të gjitha bazat ankimore, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet

ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar, të refuzohet ankesa e paditësit, dhe të vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit, si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Për më tepër në ankesë, AKP-ja ka pohuar se Gjykata e shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontekstit faktik të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur se afatet janë ngatërruar nga Gjykata. Afati i parë është ai për parashtrimin e kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e të drejtës të cilën paditësi ka kërkuar ta realizoj në Gjykatë e që është afati i aplikueshëm i parashkrimit bazuar në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Të dy këto afate janë të ndara dhe të dallueshme dhe se të dy afatet duhet të përmbushen në mënyrë që kërkesa të pranohet. Sa i përket konstatimit të gjykatës se Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës e ndërprejë parashkrimin, AKP sqaron se ky njoftim i referohet paditësit, se ai ka të drejtën të parashtrij kërkesën pranë AKP-së, dhe nuk i mbron të drejtat e tij me mjete tjera ligjore të cilat janë në dispozicion. Tutje AKP-ja e përsërit pretendimin e saj se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar. Në ankesë i referohet edhe disa rasteve nga jurisprudenca e shkallës së I-rë dhe të II-të të DHPGJS-së.

Me datë 29 prill 2024, është tentuar ti dorëzohet ankesa e AKP-së paditësit për të dhënë përgjigje në ankesë, mirëpo ai nuk e ka pranuar dërgesën, ndërsa raporti i postës është se pala është shpërngulë nga kjo adresë.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

## **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor, andaj ai duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 30 korrik 2012, e ka dorëzuar tek Autoriteti i Likuidimit të NSH IBG "Industria e Baterive "(në likuidim), një kërkesë për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,050.00 euro, e cila kërkesë ishte refuzuar me arsyetimin se paditësi nuk ishte punëtor aktiv i NSH-së, dhe nuk ishte në listën e pagave deri në ditën e privatizimit të NSH-së.

Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin e ankimuar e ka ndryshuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit duke mos u pajtuar me konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se punëtori nuk ka qenë punëtor aktiv i NSH-së deri në ditën e privatizimit të saj.

Kolegji i Apelit nuk pajtohet me konstatimet e Autoritetit të Likuidimit, ndërsa i mbështet konstatimet e dhëna nga Shkalla e parë e DHPGJS, se kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës është e mbështetur me prova të mjaftuara të cilat paditësi i ka dërguar me ankesë. Është e qartë se AKP-ja paditësit i ka dërguar Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë 08 qershor 2012, i cili dokument e ka ndërprerë rrjedhjen e afatit të parashkrimit të kërkesës.

Ne këtë njoftim shprehimisht ceket se "Shumat – pagat që u janë mbetur borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e Punëdhënësit. Kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktohen i kur të fillojnë këto procedura".

Duke u bazuar në këtë Njoftim, paditësi me arsye ka pritur fillimin e procedurës së likuidimit të NSH-se me datë 11 qershor 2013, dhe pastaj pas njoftimit të shpallur nga AKP-ja, paditësi në afatin ligjor e ka dorëzuar kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit me datë 30 korrik 2013.

Kolegji i Apelit i mbështet të gjeturat faktike të shkallës së parë të DHPGJS, pasi që me provat e dorëzuara nga ana e paditësit ai ka vërtetuar se i plotëson kushtet nga neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së që ti njihet e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,050.00 euro, e cila shumë do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, ankesa e paditurës është refuzuar si e pa bazuar, ndërsa është vërtetuar Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi tashmë ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore, me datë 28 mars 2024, në shumë prej 100 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues

\_\_\_\_\_